

## FAKTE PËR PARAZITËT (PEDIKULOZIS) E KOKËS

### SHËNJAT: SI TA KUPTOJ QË FËMIJA IM KA PARAZITË KOKE?

\* Lëkura e kokës që kruhet vazhdimisht, skuqje dhe acarim veçanërisht tek rrënjët e flokëve rreth fytyrës dhe pas veshëve.

\* Vënie re e parazitëve që lëvizin nëpër flokë ose e vezëve të parazitëve (thërrizave). **Për të gjetur shenjat e parazitëve të kokës:**

Egzaminoni pjesën e mbrapme të qafës dhe rreth veshëve me një lente zmadhuese në një vend me shumë dritë. Ju mund të mos i shikoni gjithmonë parazitët e rritur të kokës - ato lëvizin shpejt. Thërrizat janë të vogla, me formë vezake, dhe ngjiten tek njëra pjesë e rrënjës së flokëve tek lëkura e kokës ose 2.5cm nga lëkura e kokës. Nëse ato janë të patejdukshme, ato janë mundësisht guacka boshe. Nëse ato janë ngjyrë kafe ose të zezë nuk kanë çelur akoma. Lëkurat e bardha të hapura që bien kollaj kur floku shkundet janë lëkura të vdekura ose zbokth. **MOS E TRAJTONI FËMIJËN TUAJ VETËM NËSE JU GJENI NJË INFEKTIM AKTIV PARAZITËSH TË KOKËS.** Nëse ju keni dyshime – kërkojani një mjeku, berberi, infermjereje shkolle, ose ndonjë personi tjetër me eksperience që të egzaminojë fëmijën tuaj – shikoni figurat në anën e kundërt.

\* Nëse fëmija juaj ka rënë në kontakt të ngushtë me një shok, anëtar familjeje ose shok klase me parazitë koke – kontrollojeni atë rregullisht. **PARAZITËT E KOKËS NUK MUND TË KËRCEJNË, FLUTUROJNË, NOTOJNË, OSE JETOJNË MË SHUMË SE 48 ORË LARG KOKËS SË NJERIUT.** Ato janë në shumicën e rasteve shpërndarë nëpërmjet kontaktit direkt kokë më kokë – disa here nëpërmjet ndarjes së një kapeleje ose krëhëri me një person të infektuar.

### TRAJTIMET: SI TË PASTROJ PARAZITËT E KOKËS?

\* Përdor një locion ose lëng nga një farmaci që është bërë posaçërisht për parazitët e kokës. Ndiq udhëzimet **ME PËRPIKMËRI**, duke përfshirë trajtimet shoqëruese. Shumica përmbajnë një krëhër thërrizash të posaçëm. Emra popullore janë RID dhe NIX. Disa tipe flokësh dhe raste të vështira kërkojnë **NJË KRËHËR SHUMË TË MIRË** – shiko në anën e kundërt. Për përsëritje të infektimit ju duhet të ndryshoni produktet, sepse ato përmbajnë insekticide të ndryshme. **MOS PËRDORNI MË SHUMË SE DOZA E REKOMANDUAR** – Këdo produkte përmbajnë insekticide të forta. Ç’do emër mund të ketë udhëzime të ndryshme, kështu që lexoni me kujdes.

\* Juve mund të konsideroni një prerje më të shkurtër flokësh nëse fëmija juaj ka flokë të trasha dhe të gjata (për të bërë krehjen më të lehtë), por ju lutemi mos e rruani kokën e fëmijës tuaj vetën nëse fëmija është djalë dhe e pëlqen atë stil flokësh.

\* Shumica e produkteve janë efektive në mbytjen e parazitëve të rritur të kokës, gjithësesi ato nuk i mbysin të gjitha vezët. **KREHJA** është hapi më i rëndësishëm – sigurohuni që ju të pastroni krëhërin dhe ndonjë furçë ose kapëse flokësh të përdorur after ç’do periudhë krehjeje. Kriheni të gjithë flokun e lagur ç’do ditë derisa ju nuk gjeni më vezë. Sigurohuni të krihni përsëri për të egzaminuar për parasite koke ose thërriza pas trajtimit të vazhduar.

### TRAJTIMET: SI TË TRAJTOJ SHTËPINË TIME?

Parazitët e kokës nuk infektojnë mobiljet, krevatet, ose kafshët shtëpiake. Ato kanë nevojë për lëkurën e kokës së njerëzve që të jetojnë dhe në përgjithësi nuk duan të largohen nga lëkura e kokës vetëm nëse ato hiqen ose po ngordhin. Gjithësesi, rekomandohet që juve bëni çfarë vijon me gjërat që kanë rënë në kontakt të drejtpërdrejtë me një person të infektuar.

\* Lani në lavatriçe të gjitha veshjet që lahen dhe çarçafët e krevateve me ujë të nxehtë (130 gradë Fahrenheit). Dërgoni për pastrim çfarë nuk mund të lahet.

\* Ju mund të mbyllni artikujt (për 2 javë) në një qeskë plastike. Kjo përfshin, kafshët e mbushura, bataniet, etj., ose vendosini ato në tharëse të nxehtë për 20 minuta.

\* Zhytni krëhërat dhe furçet në alkool, ose pastrues të fuqishëm për 1 orë, ose ju mund t’i lani ato me sapun dhe ujë shumë të nxehtë ose valojini ato.

\* Pastroni me fshesë korenti dyshemetë dhe mobiljet. Vini re që shpërndarësit komercialë kundër parazitëve për dhomat janë toksik dhe të rrezikshëm për njerëzit me alergji, azma, gratë shtatëzëna ose gratë me fëmijë në gji.

## KUJDES:

**Njerëzit me azmë, alergji ose gratë shtatëzëna ose me fëmijë në gji duhet të konsultohen me mjekun e tyre përpara se të përdorin ç'do formulë komerciale (insekticide) për parazitët e kokës. Ka trajtime jo kimike – shikoni faqet e internetit më poshtë.**

## PARANDALIM: SI TË PARANDALOJ INFEKTIMIN PËRSËRI?

\* Trajto fëmijën tuaj në mënyrë korrekte: ndiq udhëzimet në një prodhim komercial për parazitë koke ose atë të dhënë nga një mjek ose farmacist. Shumë njerëz frikësohen kur ato zënë parazitë koke dhe shumë kura mitologjike dhe jo efektive qarkullojnë. Mos ndiqni ose shpërndani informacion jo të vërtetë!

\* Shumë trajtime kërkojnë një përsëritje të trajtimit pas 7 ose 10 ditësh. Mos e harroni këtë – edhe nëse fëmija juaj duket që nuk ka më thërriza.

\* Flisni me fëmijën tuaj rreth mos-ndarjes me të tjerët të kapeleve, shalleve, krëhërave dhe furçeve.

\* **Tregohuni i ndershëm!** Tregojini ç'do njeriu që fëmija juaj ka rënë në kontakt me parazitët – kjo mund të ndihmojë një mik dhe munësisht do të mbajë fëmijën tuaj larg infektimit të përsëritur. Parazitët e kokës janë një problem i përhapur dhe nuk kanë asgjë të bëjnë me pastërtinë ose mungesën e pastërtisë. Gjithësecili mund të infektohet me parazitë koke – duke përfshirë të rriturit.

\* **NJOFTONI MËSUESIN E FËMIJËS TUAJ MENJËHERË** – kështu që ato mund të bejnë kontroll koke të klasës.

\* **NJOFTONI STAFIN TEK TË GJITHË AKTIVITETET OSE KLASAT E PASDITES KU FËMIJA JUAJ ËSHTË I PËRFSHIRË** – parazitët e kokës shpërndahen kudo që fëmijët janë në kontakt me njëri tjetrin.

**SHËNIM: Qyteti i Nju Jorkut ka rregullore jo-thërriza.** Ju nuk mund të ktheni fëmijën tuaj në klasë derisa të gjitha parazitët e kokës janë pastruar dhe nuk ka shenja të infektimit. Një fëmijë i identifikuar me parazitë koke do të dërgohet në shtëpi menjëherë për trajtim dhe duhet të sillet tek infermjerja e shkollës ose një përfaqësues i administratës për egzaminim përpara se të kthehet në klasë.

## KUPTONI CIKLIN E JETËS SË PARAZITËVE TË KOKËS:



**Vezët (Thërrizat) :** Paraziti femër shtron vezë me një ngjites të veçantë që i çimenton ato tek pjesa e flokut afër rrënjës. Vezët zhvillohen dhe çelin afërsisht 7-10 ditë më vonë.

**Larva:** Sapo thërriza çelet, quhet larvë dhe është vështirë që të shihet me sy të zhveshur. Larva nuk mund të riprodhojë sepse ajo nuk është plotësisht e zhvilluar. Pas rreth 12 ditësh, ajo bëhet një parazit i rritur.



**Të rriturit:** Paraziti i rritur mund të shtrojë deri në 4-10 vezë në ditë – duke filluar një gjeneratë të re të parazitëve. Faza e të rriturit zgjat rreth 28 ditë.

## PËR MË SHUMË INFORMACION:

- ✓ [www.headlice.org](http://www.headlice.org) – Shoqata Kombëtare e Parazitëve – informacion i vlefshëm/lidhje në internet tek krëhërat e pastrimit të parazitëve (LiceMeister)
- ✓ [www.headlice.com](http://www.headlice.com) – Faqe në internet për të kërkuar informacion për parazitët
- ✓ [www.licessquad.com](http://www.licessquad.com) – Pastruesit e thërrizave Kanadëzë që shesin krëhëra me kualitet dhe japin këshilla të vlefshme
- ✓ <http://lancaster.unl.edu/pest/lice/headlice018.shtml> – udhëzime të detajuara në pastrimin pa përdorur kimikate
- ✓ [www.robicomb.com](http://www.robicomb.com) – Produkte për pastrimin e thërrizave pa përdorur kimikate – diktues / krëhër pastrues thërrizash i ri elektronik